

FTESE PER OFERTE

I/E nderuar Zoteri/Zonje,

1. Ju jeni te lutur te paraqitni oferten tuaj per **“Sherbimi i transportit ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise”** per nevoja të Bankës Tirana.

*Per informacion me te detajuar ju lutem shikoni **Anekset A, B, C dhe D** bashkengjitur.*

1. Ju mund te jepni oferten Tuaj per sherbimin e lartpermendur, per te cilat do te kete procedure vleresimi dhe do te lidhet kontrate me ofertuesin/ofertuesit me te mire. {Ju mund te paraqisni oferten tuaj duke u bazuar ne FTESEN PER OFERTE}.

2. Oferta Juaj duhet te dergohet ne zarf te mbyllur. Siper zarfit duhet te shenoni emrin e kompanise dhe titullin e tenderit **“Sherbimi i transportit ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise”**, dhe ta dergoni ne adresen:

Njesia e Prokurimit

Tirana Bank, Zyrat Qendrore

*Bulevardi “Zhan D’Ark”, Njesia Administrative nr. 2, Godina “MET Tirana Building”,
Tirane*

3. **Afati i fundit i pranimit te ofertave** eshte:

03.07.2026

4. **Detajet:**

Ky tender përfshin shërbimet si më poshtë:

Shërbimet do të kërkohen sipas nevojave të Bankës, pas konfirmimit nga Banka.

Shërbimi nga Baka kerkohet si si më poshtë:

- 24 orë brenda rajonit të Tiranës, qe nga momenti i njoftimit nga Banka
- 48 orë jashtë rajonit të Tiranës, qe nga momenti i njoftimit nga Banka

Nga ju mund të ofrohet kohe me e mire se sa kerkuar nga Banka.

Specifikimet teknike të kërkuara sipas Aneksit A.

Tabela e kilometrave të kërkuara sipas Aneksit B.

Lista e degëve dhe ATM sipas Aneksit C.

5. **Cmimet**

Ju do te paraqisni oferten tuaj financiare (sipas Aneksit A) si me poshte:

Kosto do te jete ne Cmim/Njesi, e detajuar per cdo ze sipas tabelës ne Aneksin A bashkengjitur, dhe duhet te perfshije zerat e meposhtem:

- Transport brenda rajonit te Tiranes
- Transport nga rajoni i Tiranes neper rrethe
- Transport nga rrethet per ne Tirane



- Perdorimi Vinçit per levizjen e mjeteve, paisjeve te ndryshme brenda rajonit te Tiranes (per pajisje max 2 ton)
- Perdorim vinci per levizjen e mjeteve, paisjeve te ndryshme (max 2 ton) jashte rajonit te Tiranes
- Punonjes ngarkim-shkarkimi deri ne 4 ore pune
- Punonjes ngarkim-shkarkimi 4.1-8 ore pune
- Punonjes ngarkim-shkarkimi mbi 8 ore pune
- Shërbim vinçi takraf me gjatesi pune/lartësi nga 10m deri ne 27m brenda rajonit të Tiranës.
- Shërbim vinçi takraf me gjatesi pune/lartësi nga 10m deri ne 27m, jashtë rajonit të Tiranës.

Ju lutemi plotesoni Aneksin A bashkangjitur ftesës per oferte.

Vlerat e mesiperme duhet te perfshijne: TVSH, cdo takse apo tatim.

Ju duhet te paraqitni Termat e pageses ne lidhje me termat e kryerjes se sherbimit.

Çmimet do te mbeten te pandryshuara gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates.

Pershkrim i detajuar jepet ne aneksin A dhe B. Plotesoni Aneksin A me oferten tuaj financiare.

6. Termat e realizimit te sherbimit

Kerkuar nga Banka:

- 24 orë brenda rajonit të Tiranës, qe nga momenti i njoftimit nga Banka
- 48 orë jashtë rajonit të Tiranës, qe nga momenti i njoftimit nga Banka

Termat e pageses lidhur me dorezimin e materialeve

Ju lutem, plotesoni Aneksin A.

7. Oferta Juaj duhet permbaje dokumentacionin e meposhtem:

A. Dokumentacion teknik dhe ligjor:

- Fotokopje e certificates se regjistrimit si person i tatueshem nga organi perkates.
- Kopje e ekstraktit te printuar nga e-albania te Regjistrimit tregtar nga QKR brenda muajit te fundit.
- CV e kompanise.
- Klientet per punime te njejta apo te ngjashme me ate te kerkuar.
- Leter Reference per bashkepunim relevant me institucione/kompani private (te pakten dy).

B. Formulari vigjilences: Plotesoni, firmosni dhe vulosni formatin bashkengjitur emailit.

8. Detajet e kontrates:

Kohezgjatja: 2 vite. Kontrata do të shtyhet automatikisht me të njëjtat kushte dhe për 1 (një) vit tjetër nëse Banka nuk kërkon me shkrim përfundimin e kontrates 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit. Draft kontrata sipas Aneksit D bashkangjitur.

9. Per informacione te metejshme ju mund te kontaktoni me:

E-mail: procurement@tiranabank.al

10. Ju lutem konfirmoni ne e-mailin e sipershenuar marrjen e kesaj ftese dhe nese ju pranoni te merrin pjese ne kete procedure prokurimi.

- 11. Ne vemendjen tuaj:** Pagesat per kompanine/te fituese per procesin e prokurimit do te behen nepermjet llogarise ne Banken Tirana dhe ne rast se nuk ka mundesi per te hapur nje llogari ne Banken Tirana, komisionet e transferimit do t'i ngarkohen kompanise.

Sinqerisht,
BANKA TIRANA



ANEKSI A – KOSTO DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr.	Pershkrimi i shërbimit	Menyra e llogaritjes së kostos	Kosto në Lek përfshirë TVSH, karburant dhe çdo shpenzim apo taksë tjetër.
1	Transport brenda rajonit të Tiranës.	<u>Kosto do të llogaritet për një rrugë, vetëm rruga me ngarkesë.</u>	
2	Transport nga rajoni i Tiranës nëpër rrethe dhe anasjelltas.	<u>Kosto do të llogaritet për km (do të llogariten të dyja rrugët vajtje-ardhje sipas tabelës së kilometrave të bashkangjitur në Aneksin B).</u>	
3	Përdorimi i vinçit (për pajisje max 2 ton) (gjatesi krahu/lartesi deri ne 10m) për transportin e mjeteve ose pajisjeve të ndryshme brenda rajonit të Tiranës.	<u>Kostoja do të llogaritet për rast/kërkesë. Nuk ka rëndësi për sa orë do të nevojitet/përdoret vinçi. Kjo kosto do t'i shtohet pikës 1 "Transporti brenda rajonit të Tiranës".</u>	
4	Përdorimi i vinçit (për pajisje max 2 ton) (gjatesi krahu/lartesi deri ne 10m) për transportin e mjeteve ose pajisjeve të ndryshme jashtë rajonit të Tiranës.	<u>Kostoja do të llogaritet për km (nuk ka rëndësi për sa orë do të nevojitet/përdoret) në një drejtim sipas tabelës së kilometrave të bashkangjitur në Aneksin B. Kjo kosto do t'i shtohet pikës 2 ose 3.</u>	
5	Punonjës për ngarkim-shkarkim deri në 4 orë pune.	<u>Kosto për shërbim puntorie ngarkim-shkarkimi që zgjat deri në 4 orë në të njëjtën ditë. Cmimi që do të ofertohej do të mbulojë angazhimin deri në 4 orë pune.</u>	
6	Punonjës për ngarkim-shkarkim nga 4.1 deri në 8 orë	<u>Kosto për shërbim puntorie ngarkim-shkarkimi që zgjat nga 4.1 orë deri në 8 orë në të njëjtën ditë. Cmimi që do të ofertohej do të mbulojë angazhimin nga 4.1 deri deri në 8 orë pune.</u>	
7	Punonjës për ngarkim-shkarkim mbi 8 orë.	<u>Kosto për shërbim puntorie ngarkim-shkarkimi që zgjat mbi 8 orë në të njëjtën ditë. Cmimi që do të ofertohej do të mbulojë angazhimin e punonjesit mbi 8 orë.</u>	
8	Shërbim vinçi takraf nga 10m deri ne 27m (me gjatesi krahu/lartesi nga 10m deri ne 27m) brenda rajonit të Tiranës.	<u>Kostoja do të llogaritet për rast/kërkesë. Nuk ka rëndësi për sa orë do të nevojitet/përdoret vinçi. Kjo kosto do t'i shtohet pikës 1 "Transporti brenda rajonit të Tiranës".</u>	
9	Shërbim vinçi takraf nga 10m deri ne 27m (me gjatesi krahu/lartesi nga 10m deri ne 27m) jashtë rajonit të Tiranës.	<u>Kostoja do të llogaritet për km (nuk ka rëndësi për sa orë do të nevojitet/përdoret) në një drejtim sipas tabelës së kilometrave të bashkangjitur në Aneksin B. Kjo kosto do t'i shtohet pikës 2 ose 3.</u>	

Cmimet duhet të përfshijnë TVSH-ne si dhe të gjitha kostot, taksat ose shpenzimet e tjera të nevojshme.
- Oferta juaj financiare duhet të jetë ekzaktesisht sipas tabelës së mesiperme.



KERKESA DHE DOKUMENTA TE TJERA

Ju lutem, jepni detajet tuaja per sa me poshte:

➤ **Afati i dorezimit te sherbimit:**

Kerkuar nga Banka:

- 24 orë brenda rajonit të Tiranës, qe nga momenti i njoftimit nga Banka
- 48 orë jashtë rajonit të Tiranës, qe nga momenti i njoftimit nga Banka

Ofruar nga Ju:

- ___ ore brenda rajonit te Tiranes
- ___ ore jashte rajonit te Tiranes

➤ **Termt e pageses:** Periudha specifike brenda se ciles Banka duhet te paguaje shumen e detyrimeve, brenda 30 diteve nga data e marrjes se sherbimit. **Ofruar nga Ju:** _____

➤ **Lista e Klienteve** me te cilet ju keni bashkepunuar specifikisht per kete produkt qe ne kerkojme ose per produkte te ngjashme: _____

➤ **Konfirmimi qe dispononi te gjithe Zerat e kerkuara nga Banka: Konfirmimi juaj:** _____

➤ **Dokumentacion teknik dhe ligjor:**

- Fotokopje e certificates se regjistrimit si person i tatueshem nga organi perkates.
- Kopje e ekstraktit te printuar te Regjistrimit tregtar nga QKR brenda muajit te fundit.
- CV e kompanise,
- Kontrata sherbimi te ngjashme. Klientet per punime te njejta apo te ngjashme me ate te kerkuar.
- Leter Reference per bashkepunim relevant me institucione/kompani private (te pakten dy).

➤ **Formulari vigjilences:** Plotesoni formularin e vigjilences bashkengjitur emalit dhe firmoseni dhe vuloseni.



ANEKSI C - LISTA E DEGËVE DHE ATM (OFF-SITE)

NR	DEGA	QYTETI	ADRESA
1	Head Office	Tirana	Blv Zhan D'Ark, Njesia Administrative Nr. 2, Godina "MET Building Tirana"
2	Lion Park Office	Tirana	Rruga e Elbasanit, Godina Lion Park 1, Tirane
3	Blv Zogu i Pare	Tirana	Bulevardi "Zogu i Pare", Nr.55/1, Tirane
4	Main Branch	Tirana	Bulevardi Zhan D'Ark, Njesia Administrative Nr. 2, Godina "MET Building
5	Premium Branch	Tirana	Bulevardi Zhan D'Ark, Njesia Administrative Nr. 2, Godina "MET Building
6	Unaza e Re Branch	Tirana	Rrethrotullimi i Blv Migjeni, Rruga "Tom Plezha", Kati 0, Njesia Nr.4, Astir
7	Blloku Branch	Tirana	Njesia Administrative Nr.5, Rruga "Ibrahim Rugova", Nderresa Nr.8 Tirane
8	Autostrada Branch	Tirana	Autostrada Tirane - Durres, Km 2 (Auto-Pasion)
9	Porcelani Branch	Tirana	Njesia adm Nr.4, Rruga "Xhanfize Keko", Godina Nr 3, Ambjenti Nr.11, Kati 1
10	21 Dhjetori Branch	Tirana	Tirana Bank Sh.a Rr. Kavajes, Godina Nr.109 Tirane (Qendra GKAM)
11	Parku Branch	Tirana	Kavajës Str, Njësi Tregtare, Kati Përdhe, Shkalla A, Tirane (Delijorgji)
12	Brryli Branch	Tirana	Arkitekt Kasemi Str, Nr.4,Kodi Postar 1005,Tirane
13	Zogu i Zi Branch	Tirana	Durresit Str, Nr.75, Kodi Postar 1023,Tirane
14	Kombinati Branch	Tirana	"Hamdi Cenoimeri" Str, Kombinat Tirane
15	Pazari i Ri Branch	Tirana	"Luigj Gurakuqi" Str,Pallati 15/1 Tirane
16	Tregu Medrese	Tirana	"Ferid Xhajko" Str Prane Ish-Uzines "DINAMO", Tirane
17	Komuna e Parisit	Tirana	Komuna e Parisit Str Tirane
18	Kamza Branch	Tirana	Pallati i Kultures, Blv. Blu,Kamez
19	Vora Branch	Tirana	"Rinia" Str, nr. 9, Vore
20	Fieri Branch	Fieri	Lagjja Kongresi i Permetit, Bulevardi Jakov Xoxa, Fier
21	Durres Branch	Durres	Rruga e Deshmoreve, Lagja Nr. 11, Pallati Xhemf, Durres
22	Vollga (Durres Porti)	Durres	Lgj Nr.1, Shetitortja "Taulantia" Bregdet, Zk. 8512, Nr. Pas. 24/179-N2, Durres
23	Vlora Branch	Vlora	Lagjja Pavaresia, Bulevardi Ismail Qemali,Vlore
24	Lushnja Branch	Lushnja	Lagja Skender Libohova, Sheshi Bashkia, Lushnje
25	Kavaja Branch	Kavaja	Lagjja nr.2, Rruga Josif Buda, Banese private, nr.4286, Kavajë
26	Berati Branch	Berati	Lagja "28 Nentori", Rruga Antipatrea,Nr.003, Berat
27	Gjirokastra Branch	Gjirokastra	Bulevardi 18 Shatori, Nd. 16, Kodi postar 6001,Gjirokaster
28	Saranda Branch	Saranda	Abedin Dino Str, Nr. 2, Sarande
29	Ksamili Branch	Ksamili	Lagjja Nr.3, Rruga Nacionale Butrinti, Nr.80, Ksamil
30	Permeti Branch	Permeti	Ish Turizmi Permet
31	Korca Branch	Korca	Lagjja nr. 7, Rruga 6 Deshmoret,Pallati 14, H.2, Kodi postar 7001, Korce
32	Elbasani Branch	Elbasani	Bulevardi Aqif Pasha, Pallati nr. 10, kati i pare, kodi nr. 3,Elbasan
33	Pogradeci Branch	Pogradeci	"Rreshit Collaku" Str. Lagja Nr 1, Godina nr. 49, Pogradec
34	Librazhdi Branch	Librazhdi	Sheshi Gjorg Golemi, Pallati nr. 22, Kati i pare, Librazhd
35	Bilishti Branch	Bilishti	Lagjja nr. 3, Superstrada e Devollit, Pallati 29, Nr. 1, Bilisht
36	Shkodra Branch	Shkodra	"Kol Idromeno" Str, Shkoder
37	Lezha Branch	Lezha	Lagjja Skenderbeg, Frang Bardhi Str, Objekti 2, Lezhe
38	Laci Branch	Laci	Lagja Nr. 3 LAC

Lista ATM (Off-site)

Nr	NAME	QYTETI	ADRESA
1	Nj.Bashkiake 2	Tirane	Rr. Petro Nini Luarasi
2	Tajvani	Tirane	Kompleksi Taiwan
3	QTU	Tirane	Autostrada Tirane-Durres KM 7
4	DPPSH (Drejtoria e Pergjitheshe Policise)	Tirane	Blvd Bajram Curri
5	Rinas Mberritje	Tirane	Aereoport Rinas, zona e mberritjes
6	Rinas Nisje	Tirane	Aereoport Rinas, zona e nisjes
7	ATM Kodra e Diellit	Tirane	Rr. Kodra e Diellit
8	TEG 1	Tirane	Qendra Tregtare TEG, katin -2, ne hollin prane Spar
9	KESH	Tirane	Rruga "Viktor Eftemiu"
10	Regency Kasino	Tirane	Taiwan
11	Myslym Shyri	Tirane	Myslym shyri
12	Arena Center	Tirane	Sheshi Italia, Arena Center



13	TEG 2	Tirane	Qendra Tregtare TEG, katin -1, ne hollin e shkalleve prane Jumbos
14	RTSH (Radio Televizioni shqiptar	Tirane	Rruga Ismail Qemali
15	TOPTANI	Tirane	Toptani Shopping Center KATI (-1)
16	SHISH	Tirane	Rr: "Kongresi I Manastirit", Prane SHISH , Tirane
17	Megatec	Tirane	Megatek
18	Gold Center-Fier	Fier	Rr.Aulona, qendra Gold Centre
19	Ital Mec	Fier	Compani Ital Mec Fier
20	ATM Memorial	Fier	Autostrada Mbrostar-Levan, prane rrethrotullimit Daullas
21	ATM Patos	Patos	Qender Patos
22	Shkozeti	Durres	Shkozet Bulevardi Kryesor
23	Durres Plazh	Durres	Lagja 13 Rr. Pavarsia Durres plazh
24	Elka	Gjirokaster	Vrisera, kompania "ELKA"
25	Shkodra Bashkia	Shkoder	Rr. 28 Nentori
26	ATM Vau Dejes	Shkoder	Vau I Dejes
27	Green coast Palase	Vlore	Green Coast,Bar Bubble, Palase, Vlore
28	Lungomare	Vlore	Shetitorja Lungomare, Vlore
29	Sheshi Flamuri	Vlore	Sheshi Flamuri, Rruga Ismail Qemali
30	Orange	Sarande	Rruga:" Naim Frasheri " prane Bar Oranges, Sarande
31	Sipa Tours	Sarande	Rr. Mithat Hoxha Lagja 4
32	Himare	Sarande	Rruga: Nacionale Himare-Sarande, tek Proper Pizza, zk. 1952, Himare
33	West Park	Korce	Qendra Tregtare "West Park", Rruga: Midhi Kostani, Korce
34	Pogradeci Bashki	Pogradec	Blvd Rreshit Collaku
35	ATM Everest	Kamez	Rruga Kamez-Fushe Kruje, Kilometri i pare
36	Prrenjas	Prrenjas	Rr. Rinia 31
37	Shijaku	Shijak	Lagja "Popullore", Shijak
38	Vala MAR	Durres, Lalez	Rezidenca Valamar, Hamallaj, Gjiri I Lalzit
39	Kelcyra	Kelcyre	Rr. Nacionale Kelcyre-Permet
40	Mamurras	Mamurras	Qender Mamurras
41	Elbasan Bulevard	Elbasan	Rruga 28 Nentori, tek Foto Adi
42	Met S2A00925	Tirane	Rruga. Bulevardi Zhan d'Ark
43	Kruje Kalaja	Kruje	Rruga Pazari I Vjeter,Kruje
44	Berati Kalaja	Berat	Rruga Mihal Komnena, hyrja per ne Kalaja e Beratit
45	Golem	Durres	Golem, prane Spar
46	Galeri by TEG	Vlore	Galeri by TEG , Green Coast 2
47	Drilon	Pogradec	Hotel pogradec 2 , Tushemisht
48	Shengjin	Shengjin	Shetitorja Wlison, Resort Coral, Shengjin
49	Gjirokaster Pazari	Gjirokaster	Rruga Gjin Zenebisi,Hotel Sopoti Gjirokaster



ANEKSI D – DRAFT KONTRATA

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

1. Objekt i kësaj kontrate është ofrimi i shërbimi të transportit nga “Shoqëria” tek “Banka” sipas specifikimeve në **Aneksin A dhe B** të kësaj kontrate.
2. “Shoqëria” është e detyruar që brenda afateve të përcaktuara në këtë kontratë të dorëzojë shërbimin sipas kërkesës nga “Banka” dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në Aneksin A dhe B të kësaj Kontrate.
3. Aneksin A dhe B janë pjesë e pandare të kësaj kontrate.

Neni 2

DORËZIMI

1. “Shoqëria” do të dorëzojë produktet e specifikuar sipas Aneksin A të kësaj Kontrate, në vendodhjen dhe brenda afatit të përcaktuar në Aneksin A të kësaj Kontrate, sipas Kilometrave në Aneksin B të kësaj Kontrate.

Neni 3

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

1. Kontrata do të jetë e vlefshme për në periudhë 2 vjeçare.
2. Kontrata do të shtyhet automatikisht me të njëjtat kushte dhe për 1 (një) vit tjetër nëse Banka nuk kërkon me shkrim përfundimin e kontratës 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit.

Neni 4

ÇMIMET DHE MËNYRA E PAGESËS

1. Çmimet e shërbimeve të përcaktuara në nenin 1 të kësaj Kontrate jepen në Aneksin A, ku përfshihen TVSH, transporti dhe të gjitha taksat dhe tatimet e detyrueshme për t’u paguar sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.
2. Paga do të bëhet në llogarinë që “Shitësi” ka pranë “Banka e Tiranës” sh.a me Nr. _____ në Lekë, 30 (dhjetë) ditë pas dorëzimit të produkteve dhe dorëzimit të faturës tek “Banka”.

Neni 5

DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

1. “Shoqëria” merr përsipër detyrimin për të kryer me cilësi shërbimin.
2. “Shërbimi” nga “Shoqëria” do të ofrohet:
 - ✓ Brenda 24 orëve, për të gjitha deget brenda Tiranës
 - ✓ Brenda 48 orëve për të gjitha deget jashtë Tiranëspas njoftimit me shkrim ose me tel nga (Personi/Departamenti përgjegjës i caktuar nga Banka).
3. “Shoqëria” është e detyruar t’i japë njoftim “Bankes” për çdo ngjarje apo fakt, i cili mund të pengojë “Shoqërinë” për të kryer shërbimin e kontraktuar në mënyrë efektive dhe të duhur sipas kërkesës të paracaktuar në kontratë dhe akteve rregulatore perkates. Keto ngjarje janë, por pa ukufizuar në to, si më poshtë vijon:
 - Në rastet kur pajisjet teknike të “Shoqërisë” kanë pësuar defekte apo dëmtime;
 - “Shoqëria” nuk ka në dispozicion për arsye të ndryshme burimet njerezore apo pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve objekt kontrate.
 - Si dhe çdo ngjarje apo fakt tjetër, që mund të pengojë “Shoqërinë” për të kryer shërbimin sipas akteve rregulatore dhe Marreveshjes së arritur.

Neni 6

DETYRIME TË PËRGJITHSHËM TË BANKËS

1. Të ushtrojë kontroll mbi cilësinë e shërbimit objekt i kësaj Kontrate.
2. “Banka” duhet të raportojë me shkrim “Shoqërisë” brenda 48 orëve nga dorëzimi i shërbimit për çdo problematikë që rezulton nga një verifikim normal i tyre. Në këtë rast, Shoqërisë merr përsipër rregullimin e problematikes.

Neni 7

RUAJTJA E SEKRETIT



1. "Shoqëria" dhe punonjësit e saj janë kategorikisht të ndaluar të kenë akses në të dhënat personale të të tretëve të mbledhura nga Banka gjatë aktivitetit të saj.
2. Palët janë të detyruara të ruajnë plotësisht konfidencialitetin dhe të mos u bëjnë të njohur të tretëve asnjë informacion që ato mund të marrin, si gjatë zbatimit të kontrates ashtu edhe pas përfundimit të saj.
3. "Shoqëria" do të marrë të gjitha masat e duhura për të mbajtur konfidencial të gjithë informacionin ose materialet bankare në të cilin punonjësit e saj mund të kenë akses për shkak të ofrimit të shërbimit dhe të mos i përdorin ose shpërndajnë tek të tjerë.
4. Punonjësit e "Shoqërisë" duhet të mbajnë konfidencial të gjithë informacionin lidhur me Bankën dhe rregullat e operimit të saj si gjatë periudhës së punësimit nga "Shoqëria" ashtu edhe pas përfundimit të saj.
5. "Shoqëria" duhet të njoftojë Bankën në rast cënimi të të dhënave personale të mbledhura nga kjo e fundit.
6. "Shoqëria" duhet të njoftojë Bankën në rast cenimi të të dhënave personale të mbledhura nga kjo e fundit.
7. "Shoqëria" duhet të njoftojë Bankën menjëherë dhe pa vonesë, për çdo dëm, dëmtim ose për çdo ngjarje tjetër të jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të shërbimit.

Neni 8

ANKIMIMET

1. Objekt ankimimi do të jetë mosrealizimi i neneve të kontrates së nënshkruar ndërmjet paleve.
2. Ankimimet do të bëhen nga "Banka" me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e konstatimit ose përfundimit të afatit të shërbimit.
3. "Shoqëria" brenda 5(pesë) ditëve nga marrja e njoftimit për ankim ndaj shërbimit, duhet të paraqitet pranë "Bankës", për të saktësuar dhe zgjidhur objektin e Ankimit në të kundërt mbetet në fuqi ankimimi i "Bankës".

Neni 9

SANKSIONET

1. Në rast se "Shoqëria" nuk e kryen ose vonon shërbimin, objekt kontrate (me përjashtim të rasteve të forcave madhore), atëherë ajo është e detyruar t'i paguajë "Bankës" një tarifë ditore të penaltetit për çdo ditëvonese në një vlerë prej **10,000 Lek**.
2. "Banka" i mban vlerën e penaltetit "Shoqërisë" nga pagesa, duke dhënë me shkrim arsyet dhe shumën totale të penaltetit.

Neni 10

DEMTIMET

1. Për çdo dëmtim fizik ose dem material që do të shkaktohet personelit të "Shoqërisë", Bankës, personelit apo klienteve të saj ose personave të tretë si rrjedhojë e moszbatimit të detyrave, si dhe moszbatimit të detyrës është përgjegjës "Shoqëria". "Shoqëria" është përgjegjëse në çdo dem që mund të shkaktohet Bankës nga veprimet keqdashëse që mund të kryhen nga punonjësit e saj gjatë kohës së ekzekutimit të kësaj kontrate ose në marrvëshjet shtese që mund të hartohen në të ardhmen, dhe është i detyruar të demshperblejë "Bankën".

Neni 11

KLAUZOLA KUNDER RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT

1. Shitesi angazhohet se nuk do të marrë, nuk do të ofrojë, premtojë ose do të japë ndonjë përfitim financiar ose të ndonjë lloji tjetër, që nuk është i detyrueshëm sipas praktikave me të mira tregtare apo kushteve kontraktuale, drejtpërdrejt ose terthorazi për ndonjë person ose subjekt të lidhur apo jo me Bankën, në këmbim që ata të veprojnë ose të mos veprojnë në kundërshtim me permbushjen e detyrave të tyre për t'i mundësuar Shitesit lidhjen dhe/ose permbushjen e kësaj Kontrate.

Neni 12

PENALITETET

1. Në rastet e vonesës në dorëzimin e shërbimit objekt i kësaj kontrate, apo kryerjen e pagesës, pas përfundimit të afateve të ankimit, si Shitesi ashtu edhe Banka janë subjekte të penalteteve të mëposhtme:
2. Për çdo ditë vonese në dorëzimin e pajisjeve, Shitesi penalizohet me të njëjten përqindje penalteti sa ajo e percaktuar në paragrafin më poshtë, mbi vlerën e pajisjeve të pa dorëzuara.



3. 11.2 Per çdo dite vonese ne pagese, Banka penalizohet sipas kamates ligjore ne fuqi, ne perputhje me Ligjin 48/2014 date 24.04.2014.

Neni 13

FORCAT MADHORE

1. Shitesi nuk e humbet garancinë e realizimit të kontratës kur mosrespektimi i detyrimeve të kontratës është rezultat i një Force Madhore.
2. Do të konsiderohet Forcë Madhore çdo ngjarje që ndodh jashtë kontrollit të “Bankes” dhe nuk përbën gabim apo neglizhencë nga ana e “Bankes” dhe që nuk mund të parashikohet. Këtu bëjnë pjesë luftrat, zjarret, përmbytjet, tërmetet, epidemitë, embargot.
3. Shitesi duhet që të njoftojë me shkrim “Bankën” për shfaqjen e fenomenit të Forcës Madhore.

Neni 14

TERHEQJA NGA KONTRATA

1. Secila pale mund te terhiqet nga kontrata, ne qofte se pala tjetere shkakton shkelje themelore te saj qe jane:
2. a. Banka konstaton se:
 - Pajisjet e dorezuara nuk plotesojne kerkesat cilesore te kontraktuara dhe Shitesi nuk i zevendeson me pajisjeve qe i plotesojne kerkesat, sipas nenit 8.
 - Shitesi vonon dorezimin e pajisjeve tej afateve te percaktuara ne kontrate.
 - Shitesi shkel detyrimet kontraktore.Ne rast se kontrata zgjidhet nga Banka per shkaqet e permendura ne paragrafet e 12.1.a, Shitesi eshte i detyruar t'i paguaje Bankes nje penalitet ne masen prej 5 % te vleres se shlyer te porosise.
- b. Shitesi mund te terhiqet nga kontrata kur Banka nuk kryen ne afat pagesat per pajisjet e marra ne dorezim prej tij, kur cilesia e tyre ka qene ne perputhje te plote me kushtet e percaktuara ne dokumentat e kerkuara
3. Kontrata do te quhet e zgjidhur per shkaqet e permendura ne paragrafin 12.1 mesiper, nese pala qe ka shkelur kushtet e kontrates nuk i permbush plotesisht ato brenda 30 diteve kalendarike nga dita qe ka marre njoftimin e pales tjetere lidhur me konstatimin e ketyre shkeljeve dhe ndreqjen e tyre.
4. Ne rast se Banka nuk do te jete e kenaqur nga cilesia e pajisjeve te reja (zevendesuese) te dorezuara, kontrata do te zgjidhet menjehere.

Neni 15

LIGJSHMËRIA DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

1. Kjo kontratë i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar.
2. Çdo mosmarrëveshje midis tyre, palët angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim, në rast se kjo nuk do të arrihet, atëherë kompetente për zgjidhjen e konfliktit midis tyre do të jetë Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.

Neni 16

TË PËRGJITHSHME

1. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse shprehen me shkrim dhe firmosen nga të dyja palët dhe i bashkengjiten kontrates ne formen e Amendamentit.
2. Kjo kontratë hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqip, të nënshkruara nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve. Të dyja kopjet kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore dhe secila palë do të marrë nga një kopje.

Neni 17

HYRJA NË FUQI

1. Kjo kontrate hartohet ne dy kopje origjinale dhe hyn ne fuqine daten __.__.2026.

